



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18 Korrik 2023

Nr: 707

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 442, 446, 447 DHE 448 ID PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 18 Korrik 2023

Nr: 707
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 442, 446, 447 dhe 448 ID.”

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, i regjistruar me nr. 442 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve gjenden në Faqen Zyrtare të Bashkisë.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, i regjistruar me nr. 446 ID, me lëndë *“Thyerje e hesthjes zgjedhore”*, me objekt denoncimi *“Ndërkohë që vlerësohet pozitivisht se pjesa më e madhe e partive politike dhe kandidatëve i kanë ç’aktivizuar reklamata politike në Facebook dhe Instagram, KRIIK evidentoi një numër faqesh që vijuan të kenë reklama aktive ditët e heshtjes zgjedhore, në 13 dhe 14 maj.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, i regjistruar me nr. 447 ID, me lëndë *“Thyerje e hesthjes zgjedhore”*, me objekt denoncimi *“Me nisjen e heshtjes zgjedhore, KRIIK monitoroi daljet publike të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në media, dhe konstatoi se disa përfaqësues apo kandidatë nëpërmjet intervistave në media kryen thirrje politike duke thyer kështu heshtjen zgjedhore.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK, i regjistruar me nr. 448 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Më datë 10.05.2023 Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kandidati i Partisë Socialiste për kryetar në këtë bashki (subjekt zgjedhor), ka zhvilluar një vizitë në një çerdhe të ndërtuar rishtaz në njësinë nr. 14 në Bashkinë Tiranë.”*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 442, 446, 447 dhe 448 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI